



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:025478

Datë: 06.09.2019

Numri i dokumentit: 00507402

P.nr.844/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, kundër të akuzuarit M.K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.532/2017 të datës 05.12.2017, e cila është plotësuar me datën 09.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 04.09.2019, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, si dhe të akuzuarit, **me datë 06.09.2019** mori dhe publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.K., nga i ati P., e ëma M., e lindur D. data e lindjes..., në Prizren, tani me vendbanim në Gjakovë, i martuar baba i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, është i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Nga data e pa vërtetuar deri me datën 10.04.2017, rreth orës 16:00/h, në fshatin F., Komuna e Gjakovës, tek “U. e Sh.”, pikërisht në Restorantin “T. F.”, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nënpar. 1.1 të Ligjit mbi armët të Republikës së Kosovës dhe atë një revole të markës “Valter” 9mm., të cilën pasi ka vërejtur prezencën e zyrtarëve policor e hedh në lumin “D. i b.”, ku pas kontrollimit në lokacionin nga policia janë gjetur dy gëzhoja kalibrit 9mm., të cilat janë konfiskuar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

II. Me datë, kohë dhe vend të njëjtën si në dispozitivin e parë të akuzuarës, i panehuri i cili ishte së bashku me Gj.P.dhe S.P., në Restorantin “ T.F.” duke festuar ditëlindjen e vajzës së tij e nxjerr revolen e markës “Valter” 9 mm, duke shtënë disa herë në ujë (lumë), derisa është njoftuar policia lidhur me rastin, dhe i pandehuri pasi ka vërejt prezencën e zyrtarëve policor

revolen e hedh në lumin “D. i b.”, ku pas kontrollimit nga policia janë gjetur dy gëzhoja kal. 9 mm, të cilat janë konfiskuar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 46, 62, 69, 73, 74 dhe nenit 374 par.1 dhe 375 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Për veprën penale nën I të Dispozitivit të aktgjykimit, ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 800 (tetëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale nën II të Dispozitivit të aktgjykimit, ME DËNIM ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 40 (dyzet) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

Ashtu që konfiskohen: 2 (dy) gëzhoja të kalibrit 9 mm, si objekte të veprës penale.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.532/2017 të datës 05.12.2017, kundër të akuzuarit M.K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Me datën 09.07.2019 Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka bërë plotësimin e aktakuzës duke i ndarë gjendjet faktike të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës për veprat penale për të cilat akuzohet i akuzuari dhe duke i ndarë kualifikimet juridike të veprave penale ashtu që të akuzuarin M.K. sipas plotësimit të akuzës e ka akuzuar për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve

nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, pasi fillimisht me aktakuzën e ngritur kishte bërë një përshkrim faktik duke i përfshirë elementet e dy veprave penale dhe kishte dhënë kualifikimin juridik se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës dhe plotësimit të saj kundër të akuzuarit M.K., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari M.K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas pikave të aktakuzës së plotësuar dhe ka theksuar se është e vërtetë se arma ka qenë e imja dhe të njëjtën e kam gjuajtur në lumin D., dhe ky veprim ka qenë sekondar pasi që kam menduar se mund të shpëtoj nga ky rast, andaj ka shtuar se jam penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm si dhe ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptojë dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës dhe plotësimit të saj, andaj i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor për veprat penale dhe të dënohet sipas ligjit.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

se i akuzuari M.K., me dashje ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrat e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”. Ndërsa në nenin 375 par.1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm e kryen : “*Kushdo që përdor armë apo materie plasëse në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej (1) deri në tetë (8) vjet*”. Ndërsa, në Ligjin për armët, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M.K. e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së plotësuar së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohet, faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 7 anëtarësh. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të njëjtë me dënim me gjobë sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj gjykate PKR.nr.216/14. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, gjykata ndaj të akuzuarit konform neneve 62, 69 dhe 374 par. 3 të KPRK-së, gjykata ka shqiptuar edhe dënimin plotësues marrjen-konfiskimin e gëzhjave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.844/17, me datë 06.09.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.